



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:271370
Datë: 26.11.2024
Numri i dokumentit: 06512271

C-III-12-0605

Paditësi

M K, Gjakovë, përfaqësuar nga av. T B, Gjakovë

Kundër

E paditura

Sh.A. “Agimi” Gjakovë, përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)** Prishtinë rr.”Dritan Hoxha”, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), Kolegji i përbërë nga gjyqtarja Hajrie Shala kryesuese e kolegjit dhe gjyqtarëve Gazmend Sylaj e Diellza Hoxha anëtarë të kolegjit, merr më 22.11.2024 këtë:

AKTVENDIM

Gjykata jep pëlqimin për tërheqjen e padisë.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Paditësja me 06.03.2007, ka parashtruar padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës kundër të paditurës AKP, për vërtetim pronësie mbi bazën e trashëgimisë dhe të ndërtimit për parcelën nr., me kulturë lokal afarist Gjakovë.

Me 04 tetor 2012, përfaqësuesi i paditëses njofton gjykatën se paditësja ka vdekur dhe nuk është bërë shqyrtimi i trashëgimisë.

Më 21 dhjetor 2012, gjykata merr Aktvendim me të cilin ndërprente procedurën duke u bazuar në nenin 13.2.6 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

Me 24 tetor 2024, e paditura AKP ka parashtruar mbrojtjen në padi duke theksuar se AKP në tërësi e kundërshton padinë. Sipas AKP-së i mungon legjitimacioni pasiv për të qenë palë në

procedurë sipas nenit 73 të LPK-së, për faktin se AKP nuk administron me Sh.A. por, me NSh. Në rastin konkret AKP nuk ka krijuar kurrfarë raporti materiale – juridike me paditësin, prandaj nuk është dhe nuk mund të jet fare palë në procedurë në këtë çështje kontestimore si rezultat i kësaj AKP e njofton gjykatën se me pronën lëndore nuk administron. Mbrojtjes i ka bashkangjitur raportin nga Agjencia Kadastrale e Kosovës –Njësia Kadastrale P-.. me pronar A K dhe L K.

Me dt. 22 nëntor 2024, përfaqësuesi i paditësit dorëzon një parashtrësë me të cilën thekson se paluajtshmëria që ishte objekt i këtij kontesti e kanë blerë trashëgimtarët e paditëses, A dhe L K nga Gjakova, në tender privatizues nga AKP-ja. Kontesti tani më nuk ka objekt, andaj padinë e TËRHEQI.

Arsyetimi Ligjor

Neni 34.1 i Ligjit për DHPGJS parasheh që, paditësi mund ta tërheq padinë e tij në çdo kohë me pajtimin e DHPGJS. Me dhënien e pëlqimit të saj Gjykata merr parasysht interesin e të gjitha palëve tjera.

Kolegji mori parasysht interesin e të gjitha palëve në këtë procedurë dhe vendosi të jep pëlqimin për tërheqjen e padisë.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 34.1 i Ligjit për DHPGJS u vendos si në dispozitiv të aktvendimit.

Këshillë Juridike

Në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS, apeli kundër këtij aktvendimi parashtrohet me shkrim për Kolegjin e Apelit të DHPGJS në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditëve nga dita e marrjes së këtij aktvendimi.

Hajrie Shala, Gjyqtare Kryesuese, _____

Gazmend Sylaj , Gjyqtar _____

Diellza Hoxha Gjyqtare _____